

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 67, datë 25.06.2024



PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PASQYRËS NR. 4, “PLANI I SHPENZIMEVE KAPITALE NGA BURIMET E VETA PËR VITET 2024-2026”, MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 195, DATË 22.12.2023, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024 - 2026 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të pasqyrës nr. 4, “Plani i shpenzimeve kapitale nga burimet e veta për vitet 2024-2026” miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 195, datë 22.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”, përsa i përket investimit me nr. rendor 55 për objektin ”Riaftësim strukturor i pallatit nr.15, rruga “Abaz Çelkupa”, rajoni nr.3, kod gis 24795” dhe për investimin

me nr. rendor 67 me objekt “Riaftësim strukturor i pallatit nr.1047 (ARVI), rruga “Taulantia”, kod gis 27498”, si më poshtë vijon:

Objekti	Vlera e Projektit	Vlera e mbikëqyrjes	Vlera e Kolaudimit
Riaftësim strukturor i pallatit nr.15, rruga “Abaz Çelkupa” 15, rajoni nr.3, kod gis 24795	81.831.881	1.100.883	100.000
Riaftësim strukturor i pallatit nr.1047 (ARVI), rruga “Taulantia”, kod gis 27498	74.079.767	1.033.700	100.000

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.06.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 389/prot.
13

Durrës, më 01.07.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.67 datë 25.06.2024 ,”Për miratimin e ndryshimit të pasqyrës nr.4, “Plani i shpenzimeve kapitale nga burimet e veta për vitet 2024-2026”, miratuar me vendimin e këshillit bashkiak nr. 195, datë 22.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024 - 2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

